



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 340/15 Prot.

Tiranë më, 31/10/2022

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 31.10.2022**

**“Për një rritje të pagave të punonjësve në masën 15%.”**

Në bazë të nenit 49, pika “c” e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në bazë të VKM Nr. 621, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, VKM Nr. 627, datë 28.09.2022 “Për ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, si dhe VKM Nr. 647, datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin më pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë” të ndryshuar, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Rritjen e pagave të punonjësve të ASA-së në masën 15%, ku 7% rriten në bazë të VKM-së dhe 8% nga vetë institucioni.
2. Ngarkohet administratori i ASA për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, por i shtrin efektet financiare prej datës 1 tetor 2022.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**EMIS ÇERAVA**

